FLAMURI I SHQIPËRISË, HISTORIA DHE QËNDITARJA MARIGO POSIO E NJË SIMBOLI QË MBAJTI GJALLË KOMBIN TONË

Ilia S LARTI

Synimi: Nëpërmjet kësaj kumtese do të synohet që nëpërmjet rrjedhave historike të rifreskojmë njohuritë e të përcjellim vlerat dhe detyrimet ndaj flamurit kombëtar Kuq-e Zi, që qëndisi Marigo Posio, simbol i gjakut të derdhur nga atdhedashësit kundër zaptusve të teritoreve tona në shekuj.
Objektivat: Nëpërmjet shtjellimit të këtyre objektivave pjesmarrësit do të arrijnë që të:
Objektivi Nr.1 Rifreskojnë rrjedhat historike të flamurit tonë kombëtar si simbol i sakrificave atdhetare
Objektivi Nr.2 Vlerësojnë Marigo Posion, si qëndistaren e flamurit e patriote që ngriti Ismail Qemali në Vlorë më 28 Nëntor 1912

Abstrakti

Nga shqiponja dykrenare e mesjetës te Vlora e vitit 1912, flamuri shqiptar nuk është thjesht një copë pëlhure kuqezi. Ai është arkiv historik, shenjë shtetësie, kujtesë lufte dhe simboli më i fortë i identitetit kombëtar shqiptar. Flamuri i Shqipërisë njihet sot zyrtarisht si një fushë e kuqe me një shqiponjë të zezë dykrenare në qendër. Flamuri kombëtar është i kuq, me shqiponjë të zezë dykrenore në mes, ndërsa forma, përmasat dhe përdorimi i tij rregullohen me ligj.
Flamuri sot: formë ligjore dhe kuptim kombëtar
Sot flamuri shqiptar ka formë të përcaktuar me ligj. Përmasat e tij janë në raportin 1 me 1.4 njësi, ose 5 me 7, ndërsa shqiponja ka krahë të hapur anash; secili krah ka nëntë pendë dhe bishti shtatë pendë.
Qendra e Botimeve Zyrtare e identifikon ligjin nr. 8926, datë 22.7.2002, si aktin që përcakton formën dhe përmasat e flamurit kombëtar, përmbajtjen e himnit, stemën e Republikës së Shqipërisë dhe mënyrën e përdorimit të tyre.
Nga ana institucionale, 28 Nëntori 1912 njihet si Dita e Flamurit dhe Festa Kombëtare e Republikës së Shqipërisë.
Kuptimi i ngjyrave dhe simbolit
E kuqja e flamurit lidhet historikisht me gjakun, sakrificën, trimërinë dhe qëndresën. Shqiponja dykrenare përfaqëson sovranitetin, forcën dhe vazhdimësinë historike të shqiptarëve. Në traditën kombëtare, ajo lidhet veçanërisht me Skënderbeun dhe me idenë e shtetit shqiptar të lirë.
Më 1912, me Shpalljen e Pavarësisë, ky simbol u zyrtarizua si flamur shtetëror i Shqipërisë.
Flamuri shqiptar është më i vjetër se Republika e Shqipërisë si shtet modern. Ai lidhet me një traditë heraldike që kalon nga perandoritë, principatat mesjetare dhe familjet fisnike shqiptare deri te Rilindja Kombëtare.
Sipas burimeve të cituara në artikullin historik, Andrea II Muzaka, pas fitoreve dhe lidhjeve me Bizantin, mori stemën me shqiponjën dykrenare, e cila më vonë u bë pjesë e trashëgimisë heraldike shqiptare.
Më pas, simboli lidhet fuqishëm me Gjergj Kastriotin — Skënderbeun. Artikulli thekson se emblema e Skënderbeut me shqiponjën dykrenare dokumentohet në vitin 1451,
Më vonë, simboli shfaqet edhe në katalogë stemash dhe në trashëgiminë e familjes Kastrioti në Itali.
Këtu qëndron një fakt i rëndësishëm: flamuri shqiptar nuk lindi papritur më 1912. Ai u ringrit më 1912. Rrënjët e tij historike lidhen me mesjetën shqiptare, me Skënderbeun, me principatat shqiptare dhe me kujtesën arbërore që mbijetoi edhe në diasporën arbëreshe.
Pas vdekjes së Skënderbeut dhe pushtimit osman të trojeve shqiptare, flamuri nuk ishte më simbol i një shteti të lirë shqiptar, sepse shteti shqiptar nuk ekzistonte. Por simboli nuk u zhduk. Ai u ruajt në kujtesën historike, në familjet fisnike, tek arbëreshët e Italisë dhe në veprimtarinë e rilindësve.
Momenti kulmor është 28 Nëntori 1912, dita e Shpalljes së Pavarësisë në Vlorë. Aty flamuri mori kuptimin më të madh politik: nga simbol historik u kthye në flamur shtetëror.
Pas shpalljes, Marigo Posio, një prej grave patriote më të njohura të asaj periudhe, përmendet si figura që qëndisi një flamur të ri.
Jemi mësuar të themi se flamurin e ka qëndisur Marigoja, e cila u largua nga vendlindja e saj Oçishti i Devollit dhe u vendos në Vlorë. Shkak i braktisjes së vendlindjes ishte persekutimi që po i bëhej atdhetarëve nga reaksioni grek. Në vitin 1904 bashkë me të shoqin u vendos në një shtëpi të lagjes Muradie, në rrugën që mban emrin e gazetarit francez Justin Goda. Shpejt ajo u fut në vatrat vlonjate me idetë e saj përparimtare, por edhe me qëndismat që bënte.
Gazeta "Arbëria" që dilte në Gjirokastër, në kohën e saj shkruan se "Flamurin kombëtar që u ngrit për herë të parë në Vlorë nga Ismail Qemali është qëndisur nga Marigo Posio mbi copën e blerë te tregtari Diamant. Qëndisja është bërë sipas modelit të shqipes që kishin vizatuar patriotët don Mark Vasa dhe Petro Fotografi. Këtë e dinin dhe shumë patriotë të tjerë. Me të hollat e saj punoi dhe 500 flamuj për zyrat e ndryshme të shtetit të parë shqiptar".

Fjalët kyçe: Flamur, qëndistare, simbol, patriotizëm, vlera atdhetare.

Hyrje

Flamuri i Shqipërisë është flamuri kombëtar shqiptar, një flamur me fushë të kuqe dhe një shqiponjë dykrenare të zezë në mes.
Shqiponja dykrenare është simbol i vjetër i përdorur që nga lashtësia në Perandorinë Bizantine, e më pas u bë simbol i fisnikëve shqiptare gjatë në mesjetë. Flamuri kombëtar shqiptar u zyrtarizua si flamur shtetëror i Shqipërisë me Shpalljen e Pavarësisë nga Perandorinë Osmane së saj më 1912.
Fusha e kuqe ka domethënien e gjakut që kanë derdhur paraardhësit tanë, ndryshe lidhet edhe me trimërinë dhe fuqinë. Shqiponja me dy krerë përfaqëson shtetin sovran të Shqipërisë. Gjithsej shqiponja ka njëzet e pesë pendë, që përfaqësojnë betejat e Skënderbeut kundër Perandorisë Osmane.

Pamja

Pamja e flamurit shqiptar është caktuar me ligj. Flamuri shtetëror paraqet një fushë të kuqe me një shqiponjë dykrenore të zezë në mes, me krahë të hapur anash. Secili nga krahët e shqiponjës ka nëntë pendë, ndërsa bishti ka shtatë pendë. Përmasat janë përcaktuar në raportin 1 me 1,4 njësi (ose ndryshe me raportin 5 me 7 njësi).



Historia e Flamurit tonë ka një rrugë po aq të komplikuar sa vetë historia e kombit tonë. Nga fillesat e kësaj historie kur dokumentohet për herë të parë forma grafike e shqiponjës e deri më sot, ka shumë fakte interesante e kthesa të befta historike.

Objektivi Nr.1 Rifreskimi i rrjedhave historike të flamurit tonë kombëtar si simbol i sakrificave atdhetare

"Flamuri ynë Kombit Shqiptar", në bazë të hulumtimeve të suksesshme, ka një zanafillë të bazuara në materiale konkrete arkeologjike e etnologjike, duke qartësuar se cila është zanafilla e shqiponjës dykrenore, motiv që kombi ynë e ka edhe simbol të flamurit që prej pesë shekujsh. Enigmën e zanafillës së shqiponjës dykrenore, e cila është trashëguar nga kohët e hershme bashkë, me besimet dhe kultin e këtij shpendi e përcjellin mjaft, historianë, studjues (vendas dhe të huaj) e deri patriotë të zëshëm
Meqenëse simbolin e flamurit tonë ne kemi shqiponjën me dy krerë, duhet që patjetër të rikthehemi në historinë e lashtë të popullit tonë dhe të bëjmë pyetjen: e kishim apo nuk e kishim kultin e shqiponjës ashtu siç e kanë pasur edhe popuj të tjerë? Nga dokumentet arkivore, mitologjike apo kultet, faktohet se shqiponjën, shqiptarët e kanë pasur tipar të botës së tyre shpirtërore.
Kjo derisa vijmë në shekullin e VI para erës së re, ku e kemi shqiponjën të dokumentuar në artefakte arkeologjike. E kemi në Ilirinë e Veriut, në mburojën e një luftëtari ilir të gdhendur në gur, e kemi në tumat e Matit në disa variante, e kemi edhe tek kultura ilire e zbuluar nga prof Muzafer Korkuti në afërsi të Apolonisë.
Kjo pati një vazhdimësi tek ne si iliro-shqiptarë, derisa u shfaq në Europën e zhvilluar të shekullit XI-XI heraldika, e cila ishte e përcaktuar saktësisht në mënyrë grafike se cila do ishte shenja që do të mbanin administratat, administrata kishtare, formacionet e ndryshme ushtarake, shtetet, princërit, etj. Që aty ne sërish kemi të dokumentuar shqiponja qoftë me një kokë, që e

kemi tek shteti i parë i Arbërit në shek XII dhe në shek XII-XIII tek familjet feudale shqiptare si tek Muzakaj, Dukagjinët, tek Kastriotët tek Gropajt e
Ohrit dhe Dibrës, etj". Meqë jemi te Kastriotët duhet thënë se sipas dokumenteve këtë stemë nuk e kishte vetë Skënderbeu, pasi ai e trashëgoi nga familja e tij, pra shqiponja dykrenore në fushë të kuqe ishte e trashëguar nga paraardhësit e tij. Në 1444 në Kuvendin e Lezhës, u vendos se ky do të jetë simboli i ri i kombit shqiptar, pasi Skënderbeu u zgjodh si kryekomandant.

Pas këtij momenti e deri në vitin 1899, Flamuri nuk pësoi më asnjë ndryshim, apo jo?

Kemi dy probleme në këtë periudhë. Shpesh herë në shkrime publicistike është thënë se ka humbur shqiponja e Kastriotëve deri në pragun e Rilindjes Shqiptare. Dokumentacioni që ofrohet, qoftë arkivor, qoftë grafik, vërteton se shqiponja dykrenore dhe flamuri i Skënderbeut nuk është harruar dhe është përdorur nëvfaza të ndryshme. Kemi të dokumentuar shqiponjën e flamurit tonë në një hartë të vitit 1459, ku janë gjithsejv54 flamuj. Pra më 1459, kohë kur Skënderbeu ishte ende gjallë, kjo hartë vërteton se në flamur ishte shqiponja dy krenare.
Po ashtu kemi shqiponjën dykrenore të flamurit të Skënderbeut në afreskun e kishës së Rodonit, si edhe në monumentin e nipit të Skënderbeut Kostandin Kastrioti, i cili është varrosur më 1500 dhe varrin bashkë me gdhendjen e shqiponjës dykrenore e ka realizuar Donika Kastrioti.
Më 1593 kemi vulën e pleqësisë së Arbrit, ku shqiponja është ekzaktësisht ajo e Skënderbeut.
Kemi dokumentacion që thotë se shqiponjën e Skënderbeut e përdorin në flamurin e tyre malësorët e veriut që i ishin bashkëngjitur Bushatllinjve në luftën kundra Bosnjës.Po ashtu ka shumë fakte interesante mbi
Lidhjen e Prizrenit ku është përdorur flamuri shqiptar. Në 1879 forca të panumërta ushtarake u nisën për të shkretuar e shkatërruar, Shqipërinë dhe Lidhjen Shqiptare të Prizrenit. Ka një ferman të sulltanit, i cili i drejtohet kryegjeneralit turk dhe i thotë të verifikojë në mënyrë të veçantë nëse ka pasur flamuj shqiptarë gjatë Lidhjes së Prizrenit. Dhe ai i përgjigjet se gjatë luftës që ka bërë Lidhja Shqiptare e Prizrenit për mbrojtjen e Plavës, Gucisë, Hotit dhe Grudës ka patur nga çetat luftarake flamuj shqiptar të kohës së
Skënderbeut, por nuk kanë qenë shumë rreth 20 apo 30. Kjo tregon se deri edhe Porta e Lartë ka qenë e interesuar për simbolin e tyre, i cili ishte simbol vërtetues për ta, që të ndjenin krenari për identitetin e tyre si shqiptar, e jo identitetin përgjithësues siç donte t'i paraqiste Perandoria Osmane. Që në vitin 1879 ky simbol ka vijuar për përhapej masivisht edhe në ornamente e qëndisma popullore, megjithëse kemi etnografë të huaj që thonë se shqiponja dykrenore ka qenë në stolitë, sidomos të xhubletës dhe të disa zonave të thella malore, motiv dekoracioni artistik paraskënderbejan. Kjo vërteton që simboli ynë nuk ka lidhje me kulturën bizantine.
Në qoftë se ne e kemi të dokumentuar në shek e VI para erës së re, në truallin ilir në disa vende shqiponjën dykrenore, atëherë nuk mund të themi se e morëm nga Bizanti, por duhet të pyesim: Bizanti nga kush e mori dhe si u krijua?
Bizanti u krijua duke asimiluar dhe përthithur kulturat e popujve që kishte pushtuar.
Bizanti mund ta ketë marrë nga ne dhe më pas ne e kemi rimarrë në një formë tjetër grafike.
Sepse në heraldikë në perandorinë bizantine si simbol përcaktues e kemi vetëm në fund të shekullit IX dhe në fillim të shekullit X. Kjo është gjendja e formës grafike të shqiponjës, formë e cila erdhi deri në vitin 1899.

Nga ky moment deri në shpalljen e Pavarësisë, cila qe rruga e flamurit?

Më 1899 Faik Konica në Bruksel fabrikoi një sasi flamujsh kombëtar. Aty shohim që ndryshoi forma grafike e shqiponjës. Kjo ishte një mençuri për të përballuar vështirësitë të kohës sepse shqiptarët kishin një vend të panjohur. Kishte disa shtete të afirmuara e me traditë si Rusia, Serbia, Mali i Zi, Austro-Hungaria, Lidhja e Shenjtë Romake, që kishin shqiponjën dykrenore.

Ndaj doli detyra që ta individualizonin shqiponjën shqiptare. Ata arritën t'i ngrenë pak flatrat e saj në mënyrë që ajo të dallohej prej të tjerave. Kjo solli për hir të së vërtetës një farë pështjellimi, pasi filluan të përdoren disa variante. Këto variante vijuan të praktikohen nga çetat kryengritëse, nga shoqatat nga klubet kulturore, etj derisa vjen 28 nëntori i 1912-s, kur ngrihet një flamur, të cilit ia njohim formën klasike të tijën. Me shpalljen e Pavarësisë të gjithë shqiptarët filluan të përdorin flamurin e Ismail Qemalit të 28 nëntorit.
Flamuri shqiptar - shqiponja dykrenëshe e zezë në sfondin e kuq - është simboli më sublim i shprehjes së identitetit të shqiptarëve, kudo që jetojnë ata. Ky flamur ka mbajtur gjallë qenësinë shqiptare në rezistencën kundër pushtuesve të huajve, sidomos gjatë shekullit XX. Flamuri është dëshmi e besnikërisë ndaj atdheut dhe ndaj kombit. Prandaj, përderisa në pothuaj të gjitha shtetet e botës presidenti betohet mbi Biblën apo Kuranin, në Shqipëri betimi i tillë bëhet para flamurit.

Flamuri kombëtar shqiptar me fushë të kuqe dhe shqiponjë dykrenare të zezë e ka zanafillën te emblemë e Gjergj Kastriot Skënderbeut dhe tradita mesjetare, ndërsa në historinë moderne lidhet ngushtë me ngritjen në Vlorë më 28 Nëntor 1912.
Zanafilla dhe Simbolika
Simboli i Kastriotëve: Shqiponja dykrenare u trashëgua nga tradita bizantine dhe u përdor nga Skënderbeu në shekullin XV për të treguar lirinë dhe rezistencën.
Kuptimi i ngjyrave: E kuqja përfaqëson gjakun e derdhur dhe sakrificën për liri, kurse e zeza simbolizon-krenarinë dhe qëndresën.


Objektivi Nr.2 Vlerësimi i Marigo Posion, si qëndistaren e flamurit e patriote që ngriti Ismail Qemali në Vlorë më 28 Nëntor 1912

Marigo Posio, qëndistarja e flamurit që ngriti Ismail Qemali në Vlorë më 28 Nëntor 1912



Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë është një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë tonë kombëtare. Më e çmuara, më e bukur që na bën të ndihemi krenarë për atdheun tonë Shqipërinë.
Epoka e Rilindjes 1832-1912 është epoka më e ndritur e historisë së Shqipërisë. Ajo nxori njerëz të mëdhenj, epokalë, të mendjes e të pushkës, të besës dhe trimërisë, të penës dhe urtësisë, nxori titanët e mendimit dhe veprimit që e nxorën Shqipërinë nga errësira 500-vjeçare otomane në dritë të vërtetë. Këta iluministë i dhanë asaj emrin epoka e dritës dhe diturisë. Ata ishin pararendësit e shpalljes së Pavarësisë së Atdheut, njëqindedhjetë vjetorin e së cilës po festojmë.
Me 28 Nëntor 1912 Ismail Qemali një udhëheqës i shquar me bashkëpunëtorët e tij bashkoi popullin tonë nga Trieste në Durrës dhe e vazhduan mbledhjen në Vlorë. Në kuvendin ndërkombëtar më 28 Nëntor 1912 u shtrua diskutim për ngritjen e flamurit dhe Nikollë Kaçorri ia zgjati flamurin.
Ismail Qemalit nga ballkoni i ndërtesës e shpalli para mijëra njerëzve nga i gjithë Shqipëria. Përgatitjet ishin kryer sidomos ajo kryesorja qëndisja e flamurit, Marigoja me duart e arta e kishte qëndisur dhe bashkë me të qëndronte para ndërtesës.
Ismail Qemali, i cili u emërua si kryeministër i parë i Shqipërisë iu drejtua Marigosë: “Sa herë që do të përmendet dita e flamurit do të përmendet edhe emri jot moj bijë.”

Ishin të gëzuar dhe brohorisnin, “e gëzofshi Pavarësinë përjetë”. Në këtë kontekst edhe sivjet ne festojmë 110 vjetorin e Pavarësisë. E vetmja festë që i bashkon të gjithë shqiptarët anë e mbanë botës është 28 Nëntori-Dita e flamurit dhe e shpalljes së Pavarësisë.



Marigo Posio, mbiemri i vajzërisë Poçi, lindi në Korçë, më 2 shkurt 1892 dhe ndërroi jetë në 23 shkurt 1932.
Ishte e bija e Papakosta Poçit dhe Lenka Ballauri me origjinë nga Voskopoja. Në familjen e saj Marigo Poçi mori mësimet e para në gjuhën shqipe.
Ishte vajza e 27 e regjistruar në shkollën e parë të vashave, më 23 tetor 1891 e për mësuese kishte Sevasti Qiriazin e ndihmësen e saj Fanka Efthimin.
Që e re u martua me Jovan Posion nga fshati Hoçisht i Krahinës (Rrethit), të Devollit Qarku i Korçës.
Për arsye të përndjekjeve të shovinistëve, rreth vitit 1904, çifti Posio u vendos në Vlorë, në lagjen “Muradie”, ku edhe sot në rrugën “Justin Godart” ndodhet shtëpia e tyre.
Shtëpi, e çiftit Posio ka pritur e përcjellë patriotë e veteranë kombëtarë nga të katër anët e atdheut. Marigoja shumë shpejt u fut në vatrat vlonjate me idetë e saj përparimtare. Kur solli plaçkat nga Korça në fund të sëndukut kish vënë dhe një flamur të qëndisur me dorën e saj. E kishte mbuluar me gazeta të vjetra të ngjitura me brumë, që të mos diktohej në rast kontrolli. Ajo u thoshte vajzave vlonjate: “Dëgjoni vajza: Në pajën tuaj duhet të keni medoemos dhe një flamur, me shqiponjë dykrenore, për të shprehur identitetin, por dhe për të sjellë mbarësi në jetën bashkëshortore.”
Kjo u kthye në traditë, ku çdo vajzë e ruante në pajën e saj si gjënë më të shtrenjtë flamurin në modelin e qëndisur nga dora e Marigosë. Kjo intelektuale e shquar, patriote e flaktë, gjente kohë të lexonte libra e shfletonte gazeta. Ishte e vetmja grua që aktivizohej në veprimtaritë patriotike të kohës, duke u bërë edhe një shembull për masën e gjerë të grave vlonjate. Në shtëpinë e Marigosë, e cila u bë vatër atdhetare, hynin e dilnin patriotët: Çerçiz Topulli, Mihal Grameno, Ibrahim Shyti, Jani Minga, Musa Çakërri tej.
Në shtypin e kohës citohej se: Marigo Posio, mori pjesë në Komitetin e Parë që u formua në Vlorë për Shpëtimin e Atdheut të cilin e ndihmoi në mënyrë modeste dhe me të holla. Në Vlorë, Marigoja iu përkushtua në fillim leximit të të gjithë autorëve të Rilindjes sonë Kombëtare dhe shumë prej poezive të tyre i dinte përmendësh.
Për kohën që jetoi, ajo kishte një kulturë dhe horizont për t’u admiruar, duke u konsideruar si gruaja më intelektuale e qytetit bregdetar. Kjo nuse hoçishtare dhe qytetare vlonjate interesohej për gjithçka që kishte lidhje me lëvizjen kombëtare, emancipimin e grave dhe në përgjithësi me çdo gjë që mbarte në vetvete fatin e atdheut të saj të robëruar.

Nga Vlora ndiqte me vëmendje veprimet e çetave patriotike kundër forcave osmane, në gjithë Shqipërinë, atyre greke në jug dhe në veri atyre serbe dhe malazeze.
Me krijimin e klubit "Labëria" në vitin 1908, Marigoja u aktivizua si këshilltare pranë kësaj qendre patriotike. Aty ajo përhapte idetë përparimtare, dhe përpiqej të përcillte ndjenjën atdhetare te brezi i ri.
Marigoja punoi si drejtoreshë e gazetës "Shpresa kombëtare" më 1921-shin. Artikujt e saj parapëlqente që t'i nënshkruante me pseudonimet "Sapi" dhe "Shqiponja".
E gjithë familja e saj iu përkushtua lëvizjes së çlirimit të kombit si: i shoqi Jovani dhe vëllai i zonjës Marigo, patrioti Thanas Viso Mborja.
Më 1910-ën Komiteti "Bashkimi", e dërgoi Marigonë në Korfuz, me qëllim që të koordinonte dhe bashkërendonte veprimet e patriotëve.
Po me këtë detyrë, shkoi dhe më 1911-ën, ku pati takime me mjaft figura patriotike.
Ditët e fundit të nëntorit 1912 oborri i zonjës Marigo u kthye në një punishte për stamposjen e flamujve dhe qylafëve me shkabën dykrenore. Ajo, së bashku me Petro Fotografin dhe Thanas Floqin, prodhoi me qindra flamuj që skuqën qytetin e Vlorës ditën e pavarësisë kombëtare. Thuhet se ajo ka qenë e pranishme edhe në ngritjen e flamurit dhe e ka parë me sytë e saj firmosjen e dokumentit të shpalljes së pavarësisë.

Jovan Posio, në qytetin e Vlorës u miqësua me patriotët Jani Minga dhe Ibrahim Shyti, cilët duke e vlerësuar për ndjenjat atdhetare, e pranuan anëtar të klubit "Labëria". Shtëpia e çiftit Posio në Vlorë u kthye një strehëz e ngrohtë për punët patriotike, të patriotëve vlonjatë e më gjerë, si: Jani Minga, Murat Toptani, Mustafa Qulli, Mihal Grameno, Pandeli Cale tej.



Familja e Jovan Posios i shërbeu me mish e me shpirt lirisë dhe çështjes kombëtare. Çdo 28 Nëntor në shtëpinë e Posiove priteshin miq e veteranë nga e gjithë Shqipëria dhe në shenjë respekti për ditën e Madhe, çdo dritare e shtëpisë mbante flamuj kuq e zi që valëviteshin gjithë krenari.
Më 1914-ën, Marigo Posio vihet në krye të përpjekjeve për të ndihmuar muhaxhirët, të cilët u vendosën në ullishtat e Vlorës. Të dëbuar nga trojet e tyre të Çamërisë prej mizorive grekë. Për këtë çështje ajo u kërkoi ndihmë financiare dy kushërinjve të saj të parë, patriotëve Spiridon e Tashko Ilo, që jetonin në Rumani.
Më 1920-ën i dërgon një telegram legatës franceze në mbrojtje të Avni Rustemit dhe mbledh të holla në favor të lirimit të tij nga burgu. Ajo ngriti zërin që Avniu të fitonte pafajësinë.
Në vitin 1924, Marigo e Jovan Posio mbështetën me të gjitha forcat e tyre Revolucionin e Qershorit dhe Fan Nolin. Në këtë kohë Marigoja sëmuret nga tuberkulozi e shkon për kurim në sanatoriumin e Vjenës. Aty u takua me patriotin Tashko Ilo dhe bashkëshorten e tij Aleksandrën, si dhe me mjaft patriotë shqiptarë në mërgim. Kur Tashkoja u kthye në atdhe, Marigoja i dërgoi një letër, ku i shkruante: "Do të shes gjithë pasurinë time dhe xhevahiret (stolitë), për Shqipërinë".
Në vitet e fundit të jetës Marigoja shkon të jetojë në Tiranë, pranë motrës së saj, Uranisë, e cila ishte martuar me patriotin e shquar Kristo Floqi. Në gjendje të mjeruar, Marigo Posio vdiq më 23 gusht 1932.

Argumente për qëndisjen e Flamurit Kombëtar, nga ana e Marigosë



Sipas Zhaneta Poçit, mbesa e Marigo Posios, Marigoja e qëndisi flamurin kombëtar sipas një modeli të Don Mark Vasa. Marigoja e qëndisi flamurin në një copë që e kishte blerë nga një tregtar me mbiemrin Diamanti. Po këtë flamur Marigoja ia dha Ismail Qemalit!
Në model të tij ajo kishte stamposur e shumë të tjerë, që u vendosën jo vetëm në ballkonin e godinës ku u ngrit Flamuri po dhe në të gjitha dritaret e saj, me përmasa 70 – 40 cm, me shkabën dy krenare në mes dhe anash me shkrimin: "Rroftë Shqipëria".
Kristo Floqi në një përkujtim të ditës së flamurit shkruante: "Këtu duhet përmendur edhe një zonjë patriote korçare, zonja Marigo Posio, e cila përgatiti me duart e saj e hartoj me mjeshtëri flamurin e parë që valoj në Vlorë, e që iu dha shqiptarëve sihariqin e shpalljes të independencës së tyre."
Gazetat e kohës në mjaft artikuj shkruanin: "Marigoja predikonte shqiptarizmin në gra e burra, shkëmbente letra me atdhetarët e shqiptarë të shpërndarë në gjithë botën".

Sipas të thënave: shoqet e fëmijërisë, Marigonë e thërrisnin -"Shqiponja"

Dhe një arsye më shumë, që thirrej "Shqiponjë", ishte se: ajo që e vogël qëndiste shqiponja. Gazeta "Arbëria", që botohej në Gjirokastër, në kohën e saj shkruante: "Flamurin Kombëtar", që u ngrit në Vlorë nga dora e Ismail Qemalit, ishte qëndisur nga Marigo Posio, mbi cohën e blerë tek tregtari Diamant.
Në shtypin e kohës zinte vend dhe një poezi me titull "Marigo Posio", me këto vargje:
Cila dorë e pat punue,
at flamur që valoi në Vlorë.
Kombit ia pat kushtue,
për me shpall lirinë tonë.
Ajo qe një atdhetare,
që shkriu plagë e pasuri.
Marigoja vajzë korçare,
e shkriu jetën për Shqipëri.

Poezia dhe publicistika e Marigosë

Ndjenjat patriotike Marigo Posio i ka shprehur edhe në shtypin e kohës, ku ka shkruar mjaft shkrime, dhe poezi. Më 28 nëntor të vitit 1918, në ditën e 6 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë, ajo do të ishte në ballë të demonstratës kundër pushtimit nga Italia dhe do të bënte thirrje në shtypin e kohës: "Atdheu mbi gjithçka".
Më 13 qershor të vitit 1920, kur Avni Rustemi, vrau Esat Pashën në Paris, Marigoja, do të thurte ndër të tjera edhe këto vargje:
Ti vrapove, porsi plumbi,
u bëre erë dhe hije.
Shkele, shkove dhe e shove,
Shqipërinë e shpëtove.
Kjo poete patriote gjente kohë të shkruante vargje edhe për luftëtarët, që tregoheshin trima në luftë:
Turp i madh, për Perëndi,

unë, ti dhe ai,
Për nderin e atij gjaku,
qysh e lëmë e qan bonjaku…

Mendimi iluminist dhe veprimtaria patriotike e shqiptares së shquar, Marigo është fiksuar në qindra artikuj dhe poezi në shtypin e kohës dhe kush i lexon ato prek patriotizmin e shqiptares së famshme: Marigo Posio.
Marigosë dhimbjet do t'i vinin njëra pas tjetrës, pas humbjes së dy vajzave u sëmur dhe vetë nga tuberkulozi dhe u detyrua të mjekohej në Vjenë. Me gjithë dhimbjet që kishte në trup, ajo mblodhi forcat dhe bashkë me aktorin e madh Aleksandër Moisiu nisi të bënte veprimtari në dobi të Shqipërisë.
Në gusht të vitit 1932, mbylli sytë qëndistarja e flamurit, patriotja dhe shqiptarja e shquar Marigo Posio. Ajo u përcoll me nderim të thellë nga mijëra vlonjatë.
Dr. Shkencave Historike Zeko Braho nga Vlora është një ndër autorët më seriozë që ka hulumtuar mbi jetën dhe aktivitetin e Marigo Pozios. Punimet e veta në vitin 1990 ia dha shkrimtares Helena Kadare e cila mbasi u njoh me përmbajtjen e tyre, u prek dhe nën përkujdesjen e saj ky punim u shtyp menjëherë, duke u mirëpritur si libër me vlera nga mijëra lexues.


Flamuri origjinal i Pavarësisë, në një kartolinë të patriotit Spiridon Ilo

Autori duke e pasuruar jetën dhe veprimtarinë patriotike të Marigosë me fakte të reja, librin e ka ribotuar kohët e fundit, dhe siç cilëson ai: -ndjehem mjaft i lumturuar që më në fund- u gjet varri i Marigosë, i kësaj gruaje të shquar e cila ka një varr madhështor në Zvërnec, si dhe një bust te Kali i Trojës në Vlorë.

Homazh veprës së Marigo Posio

Për aktivitetin e saj të pasur patriotik është dekoruar nga Presidiumi i Kuvendit Populllor me Urdhrin e Lirisë së Klasit të Dytë me këtë motivacion: "Ka punuar pa u lodhur për përhapjen e gjuhës shqipe, çlirimin dhe emancipimin e gruas shqiptare". Tiranë 7 mars 1960.
Më 15 prill 2002, (Në kuvendin e parë të Gruas së shquar, që u mbajt në Vlorë), me numër dekreti 3292, ish-Presidenti i Republikës, Prof. Dr. Rexhep Mejdani e nderoi me "Urdhrin e Flamurit", me këtë motivacion:
"Në shenjë nderimi për të gjithë brezat që i dhanë pavdekësinë kombit dhe flamurit tonë; në shenjë kujtese historike për simbolet tona të ndërtuara nëpër shekuj, me përpjekjet dhe sakrificat mbarëpopullore për liri e zhvillim, në shenjë respekti të madh për gratë shqiptare, sa frymëzuese dhe realizuese të aspiratave kombëtare, të emancipimit shoqëror dhe të integrimit në familjen e madhe demokratike".
Busti i Marigo Posios qëndron sot në qytetin e Vlorës, në lulishten që mban emrin e saj.
Për Marigonë si një grua patriote, krijuese dhe qëndistare e flamurit të ngritur më 28 nëntor 1912, në Vlorë ka një bibliografi shumë të pasur.
Kjo bën të mundur që kushdo e deri te profesionistët e fushës së historografisë shqiptare, të gjejnë të dhëna dhe fakte realiste për figurën plot dinjitet e vlera patriotike të Zonjës Marigo. Në historinë e mendimit politik e shoqëror të çerekut të parë të shekullit që iku,
Marigo Posio, zë një vend nderi, duke u shndërruar në një nga përfaqësueset më të denja të femrës shqiptare. Pikëpamjet e saj të përparuara janë vazhdimi i mendimit më të përparuar të "Rilindjes Kombëtare". Ajo shërbeu si forcë lëvizëse për përparimin e Shqipërisë, ku idetë e saj atdhetare janë aktuale edhe sot e kësaj dite.

Cilësimi nga shtypi i kohës si gruaja më e ditur e qytetit, e bënte atë një model të thjeshtësisë mes grave vlonjate, korçare, devollite dhe gjithë Shqipërisë.

Përfundime

Shqiponja me dy koka (dykrenare), është simboli historik i lirisë, pushtetit dhe identitetit kombëtar të shqiptarëve.

Kuptimi Historik

Simboli i lashtë: Në zanafillë, shqiponja dykrenare ka përfaqësuar fuqinë absolute dhe autoritetin hyjnor që në Perandorinë e lashtë Hitite.
Fisnikëria arbërore: Gjatë mesjetës, ky simbol u bë shenjë e familjeve fisnike në trojet shqiptare, të cilat tregonin kështu pavarësinë dhe fuqinë e tyre
Por flamuri shqiptar nuk është vetëm simbol i një shteti administrativ. Ai është simbol i një kombi që ka kaluar pushtime, copëtim, mërgim, ndalim gjuhe, luftëra dhe ringritje. Prandaj kuqezi nuk është thjesht estetikë. Është kujtesë.

Flamuri si pasaportë shpirtërore e kombit

Flamuri i Shqipërisë është një nga simbolet më të fuqishme të historisë shqiptare. Ai bashkon mesjetën me Rilindjen, Skënderbeun me Ismail Qemalin, arbëreshët me Vlorën, sakrificën me shtetësinë.
Në çdo epokë, regjimet janë përpjekur ta përdorin, ta ndryshojnë, ta mbulojnë me shenja të tyre. Por në thelb, flamuri ka mbetur po ai: i kuq, me shqiponjën e zezë dykrenare në mes.
Ai është dëshmi se kombet nuk jetojnë vetëm me kufij, qeveri dhe institucione. Kombet jetojnë edhe me simbole. Dhe për shqiptarët, asnjë simbol nuk ka peshë më të madhe se flamuri kuqezi.

Rekumandime

Flamuri kombëtar prek ndjenjën e ekzistimit të kombit në histori. Ai është trashëgimi e përjetësuar në simbol. Qysh nga koha e Skënderbeut, ai i bën krenarë shqiptarët dhe i bashkon rreth një fryme. Prandaj, ata janë fort të lidhur për të, sepse, përveç tjerash, ua simbolizon lirinë. Kështu qe në Krujë, më 1443, në Vlorë më 1912 e në Prishtinë, më 1999. Prandaj, nuk është aspak rastësi që shqiptarët janë ndër të paktët popuj, i cili, duke treguar respektin e skajshëm ndaj këtij simboli, e ka lartësuar atë edhe në simbolin tjetër, himnin kombëtar. Aty njëri simbol, himni, i thërret simbolit tjetër, flamurit. Kjo është ndërlidhja më e fuqishme e mundshme mes shpirtit të kombit dhe "kângës së kombit".
Në këtë ditë të veçantë, prandaj, duhet të rikujtojmë trashëgiminë tonë historike e kulturore, ta rikujtojmë lashtësinë e kombit dhe të jemi krenarë me vlerat që ia kemi dhënë kulturës e qytetërimit perëndimor, nga antika në bashkëkohësi.
Në këtë kontekst, na del për detyrë që vlerat e flamurit t`I përcjellim tek brezi më ri. Por një detyrë mjaftë të rëndësishme ju del mësimdhdhënsave në përgjithësi dhe në veçanti atyre që trajtojnë kurrikulën e historisë, që të arrijnë të ngrenë interesi dhe respektin e dashurinë për ta nderuar flamurin kombëtar, simbolin e të parëve që kanë derrdhur gjak dhe kanë sakrifikuar jetën për të valvitur flamuri drejt fitoreve.

Referencat

[1]. Histori e Popullit Shqiptar. Tiranë 2002, fq.294
[2]. Gjon Muzaka. Memorie. Tiranë 1996. fq. 24
[3]. Gjin Varfi, Heraldika Shqiptare. Tiranë 2000, fq 27
[4]. Gj. Varfi. Heraldika Shqiptare, fq. 32
[5]. Akademia e Shkencës, Historia e Popullit Shqiptar, fq.434
[6]. Historia e Popullit Shqiptar, fq.433
[7]. Eqrem Bej Vlora. Kujtime, Tirane 2003, fq.313
[8]. Kujtime, fq 313-314
[9]. E.B.Vlora, Kujtime. Tirane 2003. fq.215